

VENDIM
Nr.51, datë 5.11.2004

**PËR DHËNIEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR KOMPANISË DARFO
ALBANIA SHPK**

Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 5.11.2004 shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Departamenti i Licencave dhe i Monitorimit, në lidhje me kërkesën e bërë me datën 2.8.2004 nga kompania DARFO ALBANIA sh.p.k. për të marrë statusin e klientit të kualifikuar në bazë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të nenit 48.

Duke pasur parasysh nevojën për zbatimin e modelit transitor të tregut të energjisë elektrike, hapjen e këtij tregu në Shqipëri, në përputhje me nenin 21 të direktivës 2003/54/KE të Bashkimit Europian, si dhe faktin që ERE është në procesin e hartimit të rregullave të tregut të energjisë elektrike në zbatim të nenit 54 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI :

1. Dhënie e statusit të klientit të kualifikuar kompanisë DARFO ALBANIA Sh.p.k.
2. KESH sh.a., OST sh.a. dhe kompania DARFO ALBANIA sh.p.k. autorizohen të lidhin marrëveshje të përbashkëta të përkohshme për plotësimin e detyrimeve reciproke, derisa ERE të miratojë rregullat e tregut të energjisë elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Pjetër Dema